



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria -Vlada -Government*

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministarstvo za Finansije, Rad i Transfere - Ministry of Finance, Labour and Transfer

Agjencia Qendrore e Prokurimit / Centralma Agencija Nabavke/Central Procurment Agency

---

---

**RAPORT VJETOR I PUNËS I AGJENCISË QENDRORE TË  
PROKURIMIT**

**PËR VITIN 2023**

---

## Përmbledhje Ekzekutive

Në përputhje me detyrimin ligjor, Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) përgatitë dhe i dorëzon ministrin të Financave, Punës dhe Transfereve një raport vjetor, që pasqyron aktivitetet e prokurimit publik të udhëhequra nga AQP-ja për atë vit kalendarik. Raporti Vjetor për vitin 2023 i përshkruan aktivitetet e AQP-së në vitin paraprak dhe informon institucionet përkatëse, operatorët ekonomikë dhe të gjithë akterët profesionistë rreth funksionimit të AQP-së. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i AQP-së janë përcaktuar me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës.

AQP administrohet nga një drejtor i emëruar për një periudhë tre (3) vjeçare. Drejtori udhëheq, organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e AQP-se dhe është përgjegjës për punën profesionale të AQP-se.

Fushëveprimi i AQP-së, konform Ligjit për Prokurimin Publik, trajton dy (2) lloje kryesore të procedurave të prokurimit:

1. Kontratave të Centralizuara – AQP udhëheq aktivitetet në emër të të gjitha Autoriteteve Kontraktuese; dhe
2. Kontratave të veçanta – AQP udhëheq aktivitetet për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës, që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës dhe aktivitetet në emër të institucioneve të tjera, me aprovim të Ministrin të Financave, Punës dhe Transfereve.

Në kuadër të **kontratave të centralizuara në vitin 2023** gjatë vitit 2023 DPC ka zhvilluar procedurat e prokurimit për aktivitetet e cekura në Vendimin të Qeverisë nr. 07/140 të datës 26.04.2023 të plotësuar edhe me Vendimin të Qeverisë nr. 13/148 të datës 29.06.2023. AQP gjatë vitit 2023 ka iniciuar aktivitetet e prokurimit për 14 (katërmëdhjetë) artikujt për përdorim të përbashkët të paraparë në vendimin e vitit 2023.

Nga aktivitetet e prokuruar nga DPC janë nënshkruar 38 kontrata me vlerë **46,124,587.43€**. Vlera e parashikuar e këtyre kontratave ishte **49,761,865.31€**, ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë **3,637,277.88€**. Si dhe janë nënshkruar dy marrëveshje kornizë në vlerën totale prej **3,400,000.00€**.

Në kuadër të kontratave të veçanta në vitin 2023, AQP ka iniciuar **73 (shtatëdhjetë e tre)** aktivitetet dhe në kuadër të këtyre aktiviteteve ka nënshkruar **92 (nëntëdhjetë e dy)** kontrata në vlerë totale prej **3,818,488.43 €**. Vlera e parashikuar për këto 92 kontratat ishte **5,659,382.58 €**. Ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë **1,840,894.15 €**, që i bie rreth **32.52%**

Të gjitha dokumentet e prokurimit të AQP-së publikohen rregullisht në përputhje me dispozitat ligjore të transparencës dhe me qëllim të promovimit të veprimtarive brenda komunitetit të biznesit, autoriteteve kontraktuese dhe publikut të gjerë.

Me anë të kontratave të centralizuara është arritur një sukses i dukshëm në kursimin e kohës dhe punës të punonjësve të institucioneve publike dhe operatoreve ekonomikë dhe në uljen e numrit të procedurave të prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

## **Lista e shkurtesave**

AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit

AK – Autoritet Kontraktues

DFSHP - Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

DPC – Drejtorati i prokurimeve te centralizuara

DPV - Drejtorati i prokurimeve te veçanta

IKAP – Instituti i Kosovës për Administratë Publike

KRPP – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

LPP – Ligji i prokurimit publik

OE – Operator Ekonomik

MF – Ministria e Financave

RUOPP - Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te prokurimit Publik

UA – Udhëzimi Administrativ

## Përmbledhja

<b>1. Korniza ligjore .....</b>	<b>5</b>
<b>2. Struktura organizative .....</b>	<b>6</b>
<b>2.1 DPC Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC).....</b>	<b>6</b>
<b>2.2 DPC Drejtorati për Prokurime të Veçanta(DPV).....</b>	<b>7</b>
<b>2.3 DPC Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFSHP).....</b>	<b>7</b>
<b>3. Drejtorati për Prokurime të Centralizuara.....</b>	<b>8</b>
<b>4. Drejtorati për Prokurime të Veçanta.....</b>	<b>13</b>
<b>5. Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme .....</b>	<b>15</b>
<b>6. Aktivitete tjera të zyrtarëve të AQP-së .....</b>	<b>16</b>
<b>7. Trajnimi .....</b>	<b>16</b>
<b>8. Çështjet që ndikojnë në efikasitetin e AQP-së &amp; Rekomandimet.....</b>	<b>16</b>
<b>Aneksi 1. STRUKTURA ORGANIZATIVE.....</b>	<b>18</b>
<b>Aneksi 2. Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrimin e kontratave nga DPV .....</b>	<b>19</b>
<b>Aneksi 3. TABELA E PJESEMARRSVE NE TRAJNIME .....</b>	<b>28</b>

## 1. Korniza ligjore

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) është agjenci ekzekutive që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave (MF).

AQP është Autoritet Publik dhe Organizatë Buxhetore në kuadër të MF dhe i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë çështjet administrative. Në bazë të Ligjit mbi Prokurimin Publik (LPP) në Kosovë Nr. 04/L-042, neni 95, *i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (LPP)*, AQP ka përgjegjësinë:

- Me aprovimin paraprak të Ministrit të Financave, AQP mund të kryej në emër të një Autoriteti Kontraktues (AK) një apo me shumë aktivitete të prokurimit me qëllim të ekonomizimit të shpenzimeve (neni 95 paragrafi 1 i LPP)
- Qeveria sipas propozimit të Ministrit të Financave përpilon një listë të mallrave apo artikujve të përdorimit të përbashkët, miratohet në formën e një udhëzimi administrativ. Lista e tillë dhe çdo ndryshim i bërë në të do të publikohet në media dhe të shpallet në faqen e internetit të KRRPP-së (neni 95 paragrafi 2 i LPP). AQP pas miratimit të listës së artikujve të përdorimit të përbashkët, zhvillon aktivitetet e prokurimit për procedurat e centralizuara në emër të AK në nivel qendror dhe AK në nivel lokal.
- Me aprovim paraprak, mund të udhëheq në emër të një AK një aktivitet prokurimi (neni 95 paragrafi 4).
- Një AK mund të kërkojë nga AQP-ja që ta ndihmojë AK në fjalë në kryerjen e një aktiviteti të prokurimit (neni 95 paragrafi 4)
- Gjithashtu, kryen procedurat e prokurimit për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të republikës së Kosovës, që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës (neni 21/A paragrafi 2 i LPP-se).

Te gjitha kontrata e nënshkuara nga AQP janë obligative për AK.

AQP është përgjegjëse për kryerjen e procedurave të prokurimit deri në nënshkrim të kontratës, ndërsa menaxhimi i kontratës ë bëhet nga AK të cilat i shfrytëzojnë këto kontrata. Të gjitha obligimet monetare që rrjedhin për këto kontrata do t'i paguajnë AK nga kodet e tyre buxhetore.

## 2. Struktura organizative

Agjencia Qendrore e Prokurimit përbehet nga tri drejtorate: Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC); Drejtorati për Prokurime të Veçanta (DPV) dhe Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFShP), shih Aneksin # 1.

Vlen të theksohet se sipas Ligjit Nr. 06 L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si dhe Ligjit Nr.06 L-114 për zyrtarët publik, Drejtoritë shndërrohen në Departamente.


### 2.1 DPC Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC)

Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC) udhëheqë aktivitetet e centralizuara për AK ne nivel qendror dhe ne nivel lokal;

Përfitimet e mundshme te prokurimeve te centralizuara:

- Me prokurime të centralizuara sigurohen çmime më të mira për shkak të ekonomisë së shkallës përmes blerjes me shumicë;
- Specifikimet e standardizuara për mallra dhe shërbime shpijnë ne mallra apo shërbime me kualitative;
- Mundësia e situatave të mundshme të 'konfliktit të interesit' zvogëlohet përmes ndarjes së agjencisë kontraktuese dhe kontraktuesve;
- Puna e përbashkët, nga AQP-ja dhe Njësitë Kërkuese, ne hartimin e specifikimeve teknike dhe pjesëmarrjen në procesin e tenderimit rrit kompetencat e personelit të Njësisë Kërkuese në fusha të veçanta të prokurimit publik;
- Procedurat e ankesave do të modernizohen për shkak se ka vetëm një operator ekonomik që bën një ankesë kundër dhënies së kontratës kornizë ne krahasim me numrin e madh të të mundshme nga një formë e decentralizuar e prokurimit.


DPC ne fund të vitit 2023 ka të punësuar 5 punëtorë dhe ka këtë strukture:



Kostoja e kësaj Drejtorie në vitin 2023 ishte rreth **50,000 €** bruto për të gjithë zyrtarët.

## 2.2 DPC Drejtorati për Prokurime të Veçanta(DPV)

Drejtorati për Prokurime të Veçanta (DPV) udhëheq aktivitetet e prokurimit për Agjencitë e pavarura DPV ka të punësuar 4 punëtorë dhe ka këtë strukturë:



Kostoja e kësaj Drejtorie në vitin 2023 ishte rreth **35,000 €** bruto për të gjithë zyrtarët.

## 2.3 DPC Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFSHP).

DFSHP ka të punësuar 5 punëtorë dhe ka këtë strukturë:

Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme:

Përkthyesja e gjuhës serbe;

Zyrtarja e lartë e personelit;

Zyrtarja ligjore;

Zyrtar i logjistikes.



Kostoja e kësaj Drejtorie në vitin 2023 ishte rreth **35,000 €** bruto për të gjithë zyrtarët.

### 3. Drejtorati për Prokurime të Centralizuara

Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC), konform nenit 95, pika 2 të LPP-se dhe Vendimit të Qeverisë<sup>1</sup> nr. 07/140 të datës 26.04.2023 të plotësuar edhe me Vendimit të Qeverisë nr. 13/148 të datës 29.06.2023, vendim i cili ndryshon listën e mallrave ose artikujve të përdorimit të përbashkët, respektivisht Udhëzimin Administrativ QRK-Nr.06/2018 për zbatimin e Prokurimeve Qendrore të Prokurimit Publik, pas miratimit të listës së artikujve të përdorimit të përbashkët nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2022, ka zhvilluar aktivitetet e prokurimit për procedurat e centralizuara të miratuara në këtë Vendim.

Kryerja e procedurave të centralizuara është bere në pajtim me legjislacionin që rregullon çështjet e prokurimit publik në Kosovë dhe Udhëzimit Administrativ të aprovuar nga Qeveria për listën e artikujve të përdorimit të përbashkët.

Ne Vendimin nr. 13/148, lista e artikujve përbehej nga 14 (katërbëdhjetë) aktivitete ne nivel qendror dhe atë lokal.

Nr.	Lista e artikujve sipas Udhëzimit Administrativ <b>QRK-Nr.06/2018</b> për Zbatimin e Prokurimeve Qendrore te Prokurimit Publik	Lista e artikujve sipas Vendimit te Qeverise nr. 13/148 të datës 29.06.2023
1	Furnizimi me karburante (benzin, diezel)	Furnizimi me letër për kopje
2	Furnizimi me mazut	Furnizimi me material zyrtar
3	Furnizimi me letër për fotokopje dhe printim	Furnizimi me goma për automjete
4	Furnizimi me material zyrtar	Furnizimi me vetura të udhëtarëve
5	Furnizimi me goma për automjete	Furnizim me artikuj ushqimor
6	Furnizimi me bileta të aeroplanit	Furnizim me mobilje
7	Furnizimi me vetura të udhëtarëve	Furnizim me pajisje të teknologjisë informative
8	Furnizim me artikuj ushqimor	Furnizim me pemë dhe perime
9	Furnizim me mobilie	Vetura me qira për trupa inspektuese
10	Furnizimi me ujë të pijes	Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi – me qira
11	Furnizim me pajisje të TI-së	Furnizimi me karburante
12	Furnizim me pemë dhe perime	Furnizimi me mazut
13	Marrja me qira e veturave të udhëtarëve	Furnizimi me ujë të pijes
14	Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi – me qira	Vetura me qira

<sup>1</sup> <https://agp.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/06/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Kosoves-nr.13-148-p%C3%ABr-procedurat-e-centralizuara-p%C3%ABr-vitin-2023-1.pdf>



Gjate vitit 2023 DPC ka zhvilluar procedurat e prokurimit për aktivitetet e cekura ne Vendimit të Qeverisë nr. 07/140 të datës 26.04.2023 të plotësuar edhe me Vendimit të Qeverisë nr. 13/148 të datës 29.06.2023 të publikuar në web faqen e AQP-së, KRPP-së dhe Qeverisë. Bazuar në vendimin e Qeverise, DPC ka zhvilluar procedurat e prokurimit për të gjitha aktivitetet e cekura duke hequr ato për të cilat AQP ka kontrata aktive (ne implementim e sipër) në vitin 2023 nga vitet paraprake.

AQP gjate vitit 2023 ka iniciuar 14 (katërmbëdhjetë) aktivite, për të gjithë listën e artikujve për përdorim të përbashkët sipas Vendimit te Qeverise nr. 13/148 të datës 29.06.2023.

Kriteri i shpërblimit më i përdorur në këto aktivitetet është kriteri “Tenderi i përgjegjshme me çmimin me te ulet” ndërsa tek Furnizimi me vetura dhe Marrja me qera e veturave, pra janë dy aktivite ku është përdorur kriteri çmimi ekonomikisht më i favorshëm. Po ashtu në mënyrë që të rritet konkurrenca AQP ndan aktivitetet e prokurimit në Lote, si tek procedura Furnizim me karburante që ka qenë e ndarë në nëntë (9) Lote, ku është arritur që të nënshkruhen 9 kontrata. Apo procedura për furnizim me artikuj ushqimor aktiviteti ka qenë i ndarë në 7 Lote etj.

Nga aktivitetet e prokuruar nga DPC janë nënshkruar 38 kontrata me vlerë **46,124,587.43€**. Vlera e parashikuar e këtyre kontratave ishte **49,761,865.31€**, ndryshimi/kursimet e mundshme ne mes te vlerës se parashikuar dhe vlerës totale te kontratës janë **3,637,277.88€**. Si dhe janë nënshkruar dy marrëveshje kornizë në vlerën totale prej **3,400,000.00€**.

*Tabela e mëposhtme jep detaje të përmbledhura të kontratave të lidhura nga DPC:*

<i>Nr. rendor</i>	<i>Numri i prokurimit</i>	<i>Titulli i Kontratës</i>	<i>Data e nënshkrimit të kontraktues</i>	<i>Vlera e parashikuar</i>	<i>Vlera e kontraktuar</i>	<i>Ndryshimet</i>
1	UA/2016-22-11950-1-1-1	Furnizimi me letër - Nivel i Lokal	10.01.2023	€ 800,000.00	€ 717,172.55	€ 82,827.45
2	UA/2016-22-13406-1-1-1	Furnizim me goma verore për automjete	20.01.2023	€ 540,000.00	€ 319,944.77	€ 220,055.23
3	UA/2016-22-14324-1-1-1	Furnizim me bukë dhe brumëra të tjera – Nivel i Lokal	06.02.2023	€ 930,000.00	€ 857,350.00	€ 72,650.00
4	UA/2016-22-14086-1-1-1	Lot 1-Furnizim me inventar zyrtar tavolina pune dollap	04.05.2023	€ 900,000.00	€ 563,350.00	€ 336,650.00
5	UA/2016-22-14086-1-1-1	Lot 2 Furnizim me karriga	04.05.2023	€ 1,030,000.00	€ 383,777.00	€ 646,223.00
6	UA/2016-23-6524-1-2-5	Furnizim me ujë të pijes për nevojat e Policisë së Kosovës dhe FSK-së	30.06.2023	€ 78,000.00	€ 78,000.00	€ -
7	UA/2016-23-4696-1-1-1	Furnizim me ujë të pijes	07.08.2023	€ 980,000.00	€ 625,610.00	€ 354,390.00
8	UA/2016-23-4475-1-1-1	: Lot 1 - Furnizim me karburante për nevojat e Policisë së Kosovës	07.08.2023	€ 4,600,000.00	€ 4,599,710.32	€ 289.68

9	UA/2016-23-4475-1-1-1	Lot 2 - Furnizim me karburante për vetura për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror	08.08.2023	€ 2,700,000.00	€ 2,681,750.60	€ 18,249.40
10	UA/2016-23-4475-1-1-1	Lot 3 - Furnizim me karburante për nevojat e FSK-së	07.08.2023	€ 2,300,000.00	€ 2,298,683.31	€ 1,316.69
11	UA/2016-23-4475-1-1-1	Lot 4 - Furnizim me karburante për nxehmje, gjenerator dhe rezervuar për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror	21.08.2023	€ 10,200,000.00	€ 10,167,824.00	€ 32,176.00
12	UA/2016-23-4475-1-1-1	Lot 5 - Furnizim me karburante për Rajonin e Prishtinës (Nivel Lokal)	21.08.2023	€ 2,720,000.00	€ 2,620,482.64	€ 99,517.36
13	UA/2016-23-4475-1-1-1	Lot 6 - Furnizim me karburante për Rajonin e Prizrenit (Nivel Lokal)	21.08.2023	€ 875,000.00	€ 864,626.12	€ 10,373.88
14	UA/2016-23-4475-1-1-1	Lot 7 - Furnizim me karburante për Rajonin e Pejës dhe Gjakovës (Nivel Lokal)	21.08.2023	€ 1,720,000.00	€ 1,656,774.28	€ 63,225.72
15	UA/2016-23-4475-1-1-1	Lot 8 - Furnizim me karburante për Rajonin e Ferizajit dhe Gjiçanit (Nivel Lokal)	07.08.2023	€ 1,675,000.00	€ 1,674,254.21	€ 745.79
16	UA/2016-23-4475-1-1-1	Lot 9 - Furnizim me karburante për Rajonin e Mitrovicës (Nivel Lokal)	08.08.2023	€ 885,000.00	€ 851,084.56	€ 33,915.44
17	UA/2016-23-4807-1-1-1	Furnizim me Pemë Perime - Marrëveshje kornizë	07.08.2023	€ 1,300,000.00	€ 1,300,000.00	€ -
18	UA/2016-22-3427-1-1-1	Furnizim me materiale te ndryshme zyrtare- Nivelit qendror	21.08.2023	€ 1,200,000.00	€ 877,115.35	€ 322,884.65
19	UA/2016-23-6063-1-1-1	Furnizimi me material te ndryshëm zyrtar Nivelit Lokal	20.09.2023	€ 940,000.00	€ 732,008.73	€ 207,991.27

20	UA/2016-23-4726-1-1-1	Furnizim me letër për kopje për Nivelin Qendror	28.09.2023	€ 756,000.00	€ 552,750.00	€ 203,250.00
21	UA/2016-23-4726-1-1-1	Furnizim me letër për kopje për Nivelin Lokal	28.09.2023	€ 566,250.00	€ 418,650.00	€ 147,600.00
22	UA/2016-23-10345-2-1-5	Vetura me qira kategoria 1 dhe 2	03.10.2023	€ 197,880.00	€ 197,880.00	€ -
23	UA/2016-23-10345-2-1-5	Vetura me qira kategoria 3	03.10.2023	€ 67,680.00	€ 65,952.00	€ 1,728.00
24	UA/2016-23-6106-1-1-1	Furnizimi me goma për automjetet e Nivelit Qendror	10.10.2023	€ 408,000.00	€ 382,105.50	€ 25,894.50
25	UA/2016-23-6106-1-1-1	Furnizimi me goma për automjetet e Nivelit Lokal	10.10.2023	€ 355,000.00	€ 306,083.40	€ 48,916.60
26	UA/2016-23-6106-1-1-1	Furnizimi me goma për automjetet e Policisë së Kosovës	10.10.2023	€ 437,000.00	€ 351,495.20	€ 85,504.80
27	UA/2016-23-5755-1-1-1	Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informativë	30.10.2023	€ 2,100,000.00	€ 2,100,000.00	€ -
28	UA/2016-23-8964-2-1-1	Lot 3 VETURA TË MËDHA	06.11.2023	€ 421,200.00	€ 420,264.00	€ 936.00
29	UA/2016-23-8964-2-1-1	Lot 1 VETURA TË VOGËLA	06.11.2023	€ 391,200.00	€ 391,160.88	€ 39.12
30	UA/2016-23-8964-2-1-1	Lot 2 VETURA TË MESME	06.11.2023	€ 806,400.00	€ 806,346.24	€ 53.76
31	UA/2016-23-5464-1-1-1	Furnizim me Mazut	21.12.2023	€ 1,880,000.00	€ 1,815,061.46	€ 64,938.54
32	UA/2016-23-9179-1-1-1	Lot 1 - Furnizim me mish gjedhi dhe produkte të mishit të gjedhit	13.12.2023	€ 1,500,000.00	€ 1,302,750.00	€ 197,250.00
33	UA/2016-23-9179-1-1-1	Lot 2 - Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës	13.12.2023	€ 400,000.00	€ 368,300.00	€ 31,700.00
34	UA/2016-23-9179-1-1-1	Lot 4 - Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor	01.12.2023	€ 1,270,000.00	€ 1,137,864.20	€ 132,135.80
35	UA/2016-23-9179-1-1-1	Lot 6 - Furnizim me bukë dhe brumëra të tjera – Niveli Qendror	30.11.2023	€ 900,000.00	€ 832,000.00	€ 68,000.00
36	UA/2016-23-9179-1-1-1	Lot 7 - Furnizim me bukë dhe brumëra të tjera – Niveli Lokal	22.12.2023	€ 1,050,000.00	€ 1,011,880.00	€ 38,120.00
37	UA/2016-23-13954-1-1-5	Lot 1 - Lot 3 - Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit	27.12.2023	€ 183,217.65	€ 175,234.95	€ 7,982.70

38	UA/2016-23-13954-1-1-5	Lot 2 - Lot 5 – Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor	27.12.2023	€ 290,037.66	€ 289,361.16	€ 676.50
39	UA/2016-23-5626-1-1-1	Lot 10 - Furnizim me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës - Modeli 10	06.10.2023	€ 1,209,000.00	€ 1,140,180.00	€ 68,820.00
40	UA/2016-23-5626-1-1-1	Lot 13 - Furnizim me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës - Modeli 13	08.09.2023	€ 1,600,000.00	€ 1,589,750.00	€ 10,250.00
<b>Gjithsejtë:</b>				<b>€53,161,865.31</b>	<b>€ 49,524,587.43</b>	<b>€3,637,277.88</b>

#### 4. Drejtorati për Prokurime të Veçanta

Drejtorati për prokurime të Veçanta (DPV) , konform nenit 21/A, pika 2 dhe nenit 95.4 të LPP-se, ka zhvilluar aktivitetet e prokurimit komform LPP-së në fuqi.

Ne kuadër të kontratave të veçanta në vitin 2023, AQP ka iniciuar **73 (shtatëdhjetë e tre)** aktivitete dhe në kuadër të këtyre aktiviteteve ka nënshkruar **92 (nëntëdhjetë e dy)** kontrata në vlerë totale prej **3,818,488.43 €**. Vlera e parashikuar për këto 92 kontratat ishte **5,659,382.58 €**. Ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë **1,840,894.15 €**, që i bie rreth **32.52%**.

Këto rezultate të kursimeve të mjeteve buxhetore janë arritur falë transparencës, punës profesionale që kanë treguar zyrtaret e Drejtoratit të Prokurimeve të Veçanta dhe bashkëpunimit të mirëfillte me zyrtaret e Autoriteteve Kontraktuese për të cilat janë zhvilluar aktivitetet e prokurimit.


Vlera e parashikuar për aktivitetet e zhvilluara në bazë të nenit 21/A dhe 95.4 të LPP-së caktohet nga institucionet / njësitë e kërkesës kur dërgojnë kërkesat e tyre në AQP për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit dhe si rrjedhojë ka pasur aktivitete të cilat janë anuluar për arsye se ofertat e pranuar kanë tejkaluar në mënyrë substanciale vlerën e parashikuar.

Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrim të kontratave është e paraqitur në **Aneksin 2** të raportit.

DPV gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit, varësisht nga natyra apo vlera e parashikuar e kontratës, ka përdorur procedurën e hapur, kuotim të çmimit , procedurën e vlerës minimale apo procedurën e negociuar pa publikim.

VLERA E KONTRATAVE SIPAS LLOJEVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT	
Lloji i Procedurës	Vlera e kontratave:
Procedurë e hapur	€ 2,490,759.33
Procedurë e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës	€ 815,050.00
Procedurë e kuotimit të çmimeve	€ 35,132.52
Procedurë e vlerës minimale	€ 12,072.78
Mini Tender	€ 465,473.80
<b>Gjithsejtë</b>	<b>€ 3,818,488.43</b>

### VLERA E KONTRATAVE SIPAS LLOJEVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT:



Grafiku nr. 1. Vlera e kontratave të nënshkuara nga Drejtorati për Prokurime të Veçanta sipas llojit të procedurës

## 5. Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Aktivitetet kryesore të realizuara të këtij drejtorati janë si më poshtë:

- Hartimi i Draft Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AQP
- Planifikimi i buxhetit për vitin 2024, përgatitja e planit të rrjedhës së parasë në baza tremujore dhe mujore;
- Përgatitja dhe dorëzimi i barazimeve mujore, tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore, njëvjeçare dhe barazimi me zyrën e kontabilitetit pranë Departamentit të Thesarit/MFPT;
- Realizimi i procesit të pagesave për vitin 2023;
- Finalizimi i Raportit për Pasqyrat Financiare për vitin 2023 në AQP
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e informatave për burimet njerëzore, logjistike dhe përkthyesve.
- Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe procedurave standarde lidhur me buxhetin, financat, burimet njerëzore, logjistike etj.
- Mbikëqyrja dhe monitorimi i proceseve të rekrutimit dhe çështjeve lidhur me BNJ, logjistike etj.

Në bazë të Ligjit nr.08 /L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Agjencia Qendrore e Prokurimit, në tabelën në vijim ka prezantuar shpenzimet në totalin prej **180,978.55** Euro, nga tri (3) kategori të ndryshme ekonomike:

Kategoria: Mallra dhe shërbime /Paga dhe mëditje/Komunali	Shuma
Paga dhe mëditje Janar-Dhjetor 2023	146,279.17
Mallra dhe shërbime	33,837.31
Komunali/telefoni fikse	862.07
<b>Totali</b>	<b>180,978.55</b>

Siç vërehet edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme, AQP-ja nuk ka pas buxhet në kategorinë e kapitaleve dhe në të hyra, gjatë vitit raportues 2023.

Në nivel të AQP-së është ndryshuar dhe plotësuar Projekt rregullorja për Organizimin e brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP), të cilën AQP-ja e ka përcjellë në Ministrinë e Punëve të Brendshme për procedura të mëtejshme të miratimit.

## 6. Aktivitete tjera të zyrtarëve të AQP-së

- Konform dispozitave ligjore, kemi përgatitur Raportin Vjetor për Kontrata të nënshkuara gjatë vitit fiskal 2022 (formën standarde të KRPP-se)
- Konform nenit 95 paragrafi 4, sipas kërkesave të disa Autoriteteve Kontraktuese, kemi dhënë mbështetje dhe këshilla në kryerjen e disa aktiviteteve të prokurimit.
- AQP kalkulon çmimin e karburanteve duke u bazuar në çmimin e berzës (S&P Global Platts) dhe e publikon në baza mujore në web faqen e AQP-së, i cili çmim përdoret për faturim nga ana e OE

## 7. Trajnimi

Në vitin 2023, personeli i AQP-së ndoqi programet e mëposhtme të trajnimit:

- Gjashtë zyrtar kanë ndjekur programin e avancuar për prokurim publik organizuar nga KRPP në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP).
- Një zyrtar ka ndjekur trajnimin për urdhër blerje në SIMFK.
- Një zyrtar ka ndjekur trajnim për Transferim, Pezullim dhe Përfundimin e marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil
- Një zyrtar ka ndjekur trajnim për Planifikimin e Burimeve Njerëzore (Hartimi i planit të Personelit)
- Një zyrtar ka ndjekur trajnim për Sistematizimi i vendeve të punës
- Shih Aneksin 3.

## 8. Çështjet që ndikojnë në efikasitetin e AQP-së & Rekomandimet

### Çështjet që ndikojnë në efikasitetin e AQP-së

- Numri i vogël i zyrtarëve të prokurimit, kur dihet se DPC kryen aktivitetet e centralizuara dhe DPV zhvillon aktivitetet e prokurimit për 15 agjenci të pavarura si dhe institucionet tjera në bazë të nenit 95.4 të LPP-së;
- Mos harmonizimi i planeve të prokurimit të Agjencive të Pavarura ndikon tek DPV, ku shpesh herë jemi obliguar që të zhvillojmë disa aktivitete të prokurimit për mallra apo shërbime të njëjta, por në periudha të ndryshme kohore, që konsiderohet ndarje e kërkesave;
- Hartimi jo profesional i specifikave teknike nga Agjencitë e Pavarura shkakton humbje të kohës për DPV;
- Vonesa me kthim të përgjigjeve nga ana e AK-ve si dhe kthimi i përgjigjeve jo profesionale në disa raste;
- Emërimi i personave joprofesional si anëtare të komisionit të vlerësimit nga ana e AK-ese

### Rekomandime për të përmirësuar efikasitetin e AQP-së:

- Shtimi i numrit të punëtorëve;
- Organizimi dhe financimi i punëtorëve nga AQP-ja në të cilat zyrtarët përgjegjës të Agjencive të Pavarura dhe zyrtarët përgjegjës të AQP-së do të marrin pjesë për të harmonizuar planet e prokurimit si dhe diskutime tjera të nevojshme.
- Hartimi i specifikimeve teknike në mënyrë profesionale dhe në përputhje me LPP nga ana e AK;



- Zyrtaret përgjegjës nga AK duhet të përgjigjen në kohë sa më të shkurtë dhe në mënyre profesionale pasi që AQP kryen procedurat për ta dhe arritja e një kontrate të centralizuar sa më profesionale dhe në kohë do të shërbejë për të gjitha institucionet që e shfrytëzojnë atë dhe do të ndikoj në rritjen e efikasitetit të punës së tyre;
- AK-ese për anëtare të Komisioneve të Vlerësimit të propozojnë anëtarë me njohuri profesionale mbi aktivitetet e prokurimit që zhvillohet;
- Duhet të shtohet pjesëmarrja e zyrtarëve të AQP-së, në seminare dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit në lidhje me praktikën më të mira të prokurimit publik;


### **Kërkesat për vitin 2024 për përbushjen e planeve dhe obligimeve:**

- Rritja e numrit të zyrtarëve të prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit; Kjo për arsye se kemi numër të vogël të stafit si në DPC ashtu edhe në DPV
- Shtimi i fondeve për trajnime dhe për mbulimin e shpenzimeve për angazhimin e ekspertëve në hartimin e termave të referencës/specifikimeve teknike;
- Organizimi dhe financimi nga AQP-ja i një punëtorie (në të cilin do të marrin pjesë Zyrtaret Përgjegjës të Agjencive të Pavarura dhe Zyrtaret Përgjegjës të AQP-se për harmonizimin e planeve përfundimtare të prokurimit për vitin fiskal 2024;
- Organizimi i dy punëtorive, një me zyrtarë të nivelit qendror dhe tjetra me zyrtarë të nivelit lokal për harmonizimin e kërkesave dhe qëllimeve dhe për uniformimin e dokumenteve për paraqitjen e kërkesave dhe specifikimeve teknike;
- Kërkohej disiplinë dhe përgjegjësi e njësive kërkuese përkatësisht e Autoriteteve kontraktuese në ofrimin e shënimeve dhe specifikimeve teknike për aktivitetet e prokurimit që duhet të zhvillojë AQP-ja;
- Kërkohej që Autoritetet Kontraktuese që dërgojnë kërkesa për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit në AQP që specifikat teknike të hartojnë në mënyrë profesionale dhe në harmoni me depozitat e LPP;
- Kërkohej që Autoritetet Kontraktuese për të cilat zhvillohen aktivitetet e prokurimit për pjesëmarrje në komisione të vlerësimit të ofertave të propozojnë anëtarë që kanë njohuri lidhur me mallrat, shërbimet, punët, që prokurohen;
- Të jepet mundësia që Zyrtaret e prokurimit të AQP-se të dërgohen në seminare dhe trajnime në vende dhe jashtë vendit që ligjërohen tema nga zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit sipas Rregulloreve dhe legjislacionit evropian.
- Të respektohen nga institucionet publike afatet kohore të vendosura nga AQP-ja për kthimin e përgjigjeve.

### **Arsyetim**

- Përkrahja institucionale, financiare dhe kuadrore e AQP-së do të rezultojë me kursime milionëshe, me kursim të kohës dhe mjeteve për AK.
- Po është e pritshme edhe përzgjedhja e kompanive serioze me ç'rast pritet të sigurohet furnizime dhe shërbime më cilësore dhe çka është më e rëndësishmja të gjitha institucionet publike që shfrytëzojnë kontratat e centralizuara marrin produkte dhe shërbime të njëjta, pra kontratat e centralizuara standardizojnë produktet dhe shërbimet.
- AQP gjatë punës së vet do të angazhojë edhe zyrtarë nga AK të nivelit lokal dhe qendror të cilët mund të fitojnë përvojë në punë ekipore në vlerësimin e projekteve me vlera të mëdha.
- Një AQP e përkrahur do të jetë një storie suksesi për Ministrinë e Financave dhe për AK duke siguruar kontrata të dobishme dhe duke përbushur arsyen e ekzistimit të saj

## Aneksi 1. STRUKTURA ORGANIZATIVE



## Aneksi 2. Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrimin e kontratave nga DPV

2.1 Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrimin e kontratave nga DPV sipas nenit 21.A të LPP-së për Agjencitë e Pavarura.

<i>Nr. rendor</i>	<i>Numri i prokurimit</i>	<i>Titulli i Kontratës</i>	<i>Data e nënshkrimit të kontraktues</i>	<i>Vlera e parashikuar ne €</i>	<i>Vlera e kontraktuar ne €</i>	<i>Ndryshimet</i>
1	UA/2016-22-14452-2-2-1	Shërbimet e sigurimit shëndetësor për nevojat e Fondit për Kursime Pensionale te Kosovës	26.01.2023	€ 11,500.00	€ 10,074.00	€ 1,426.00
2	UA/2016-23-891-1-4-7	Furnizim me material higjenik për nevojat e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës	15.02.2023	€ 900.00	€ 883.40	€ 16.60
3	UA/2016-23-1488-5-5-8	Lot I Furnizim me pajisje të IT-së për nevojat e Agjencive të Pavarura	07.04.2023	€ 73,600.00	€ 73,082.00	€ 518.00
4	UA/2016-23-1488-5-5-8	Lot II Furnizim me pajisje te IT-së për Nevojat e ARKEP	07.04.2023	€ 16,500.00	€ 9,690.00	€ 6,810.00
5	UA/2016-23-1488-5-5-8	Lot III Furnizim me pajisje te IT-së për Nevojat e APK	07.04.2023	€ 18,500.00	€ 17,125.00	€ 1,375.00
6	UA/2016-23-2265-1-4-7	Furnizim me veshmbathje sigurie për inspektor	20.03.2023	€ 958.00	€ 899.48	€ 58.52
7	UA/2016-23-1112-1-3-6	Furnizim me fasiklla specifike për nevojat e Agjencive të Pavarura	17.03.2023	€ 3,800.00	€ 2,350.00	€ 1,450.00
8	UA/2016-23-1435-1-2-1	Furnizim me material zyrtar për nevojat e Agjencive të Pavarura	06.04.2023	€ 19,000.00	€ 12,835.98	€ 6,164.02
9	UA/2016-23-1393-1-2-1	PJESA (LOT) III - Furnizim me pajisje tjera të TI-së për nevojat e Agjencive te Pavarura	19.04.2023	€ 5,760.00	€ 5,740.50	€ 19.50
10	UA/2016-23-2240-1-3-6	Furnizim me Inventar për nevojat e Agjencive të Pavarura	18.04.2023	€ 5,450.00	€ 2,999.00	€ 2,451.00

11	UA/2016-23-1581-2-2-1	Avancimi përditësimi i platformës ARKEP Nettest me kodin e BEREC Nettest për monitorimin e parametrave të QoS të shërbimeve të qasjes në internet për nevojat e ARKEP-it	19.04.2023	€ 70,800.00	€ 70,750.00	€ 50.00
12	UA/2016-23-2985-1-3-6	Furnizim me tepihë dhe perde për nevojat e Agjencive të Pavaruara	08.05.2023	€ 4,340.80	€ 3,135.32	€ 1,205.48
13	UA/2016-23-3539-2-3-6	Furnizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të monitorimit për nevojat e Zyrës së Rregullatorit për Energji	10.05.2023	€ 4,500.00	€ 4,402.00	€ 98.00
14	UA/2016-23-4204-1-3-6	Renovim i licencës DevExpress Universal për nevojat e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës	19.05.2023	€ 2,500.00	€ 2,495.00	€ 5.00
15	UA/2016-23-3487-2-2-1	Mirëmbajtja e sistemit për monitorimin e kualitetit të shërbimeve të zërit për nevojat e ARKEP-it	19.05.2023	€ 35,000.00	€ 33,886.38	€ 1,113.62
16	UA/2016-23-3670-1-2-1	Furnizim me Licenca VMware	23.05.2023	€ 8,500.00	€ 6,556.49	€ 1,943.51
17	UA/2016-23-3670-1-2-1	Ripërtërija e Licencave për Antivirus	23.05.2023	€ 6,500.00	€ 5,347.60	€ 1,152.40
18	UA/2016-23-5302-5-5-8	Furnizim me PC për nevojat e Organit Shqyrtues të Prokurimit	29.06.2023	€ 3,600.00	€ 3,520.80	€ 79.20
19	UA/2016-23-3670-1-2-1	Furnizim me Licenca VMware	23.05.2023	€ 8,500.00	€ 6,556.49	€ 1,943.51
20	UA/2016-23-3670-1-2-1	Ripërtërija e Licencave për Antivirus	23.05.2023	€ 6,500.00	€ 5,347.60	€ 1,152.40
21	UA/2016-23-3622-1-2-1	Furnizim me pajisje zërimi për konferencë dhe TV konferencë për nevojat e Zyres së Rregullatorit për Energji	08.06.2023	€ 26,000.00	€ 25,747.30	€ 252.70
22	UA/2016-23-3622-1-2-1	Smart TV dhe mbajtës i lëvizshëm me rrota për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media	08.06.2023	€ 3,196.00	€ 2,963.90	€ 232.10
23	UA/2016-23-4332-2-2-1	Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve të APRK-së	12.06.2023	€ 90,000.00	€ 83,472.00	€ 6,528.00
25	UA/2016-23-3915-1-2-1	Furnizim me Harduer të Teknologjisë Informative për nevojat e ZRRE-së	20.06.2023	€ 55,500.00	€ 54,673.99	€ 826.01

28	UA/2016-23-3924-1-2-1	Furnizim me pajisje për avancimin e shërbimeve të IT-së dhe KOS-ix për nevojat e ARKEP-it	23.06.2023	€ 83,000.00	€ 46,369.69	€ 36,630.31
29	UA/2016-23-4728-1-3-6	Furnizim me material higjenik për Nevojat e Agjencive të Pavarura	20.06.2023	€ 2,700.00	€ 2,556.20	€ 143.80
30	UA/2016-23-6781-1-4-7	Furnizim me letër me masa mbrojtëse të sigurisë për nevojat e AAC-së	05.07.2023	€ 986.00	€ 918.00	€ 68.00
31	UA/2016-23-6162-1-3-6	Furnizim me rafta dhe ormana metalik me qelës për nevojat e agjencive të pavarura	13.07.2023	€ 5,700.00	€ 4,107.00	€ 1,593.00
32	UA/2016-23-4242-2-2-1	Inicimin për angazhimin e një ekspertit për ofrimin e konsulencës për Implementimin e projektit për bartshmërinë e numrave për nevojat e ARKEP-it	11.07.2023	€ 15,000.00	€ 14,943.00	€ 57.00
33	UA/2016-23-5008-2-2-1	Zhvillimi i bazës së të dhënave për nevojat e Akademisë së Drejtësisë	14.07.2023	€ 50,000.00	€ 24,200.00	€ 25,800.00
35	UA/2016-23-5737-2-2-1	Larja e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura	14.07.2023	€ 22,378.00	€ 20,516.70	€ 1,861.30
36	UA/2016-23-7448-2-4-7	Shërbime për BACKUP për server dhe siguri të serverit për nevojat e KPMSHCK-së	20.07.2023	€ 400.00	€ 380.00	€ 20.00
37	UA/2016-23-6193-1-2-1	Renovim i licencave të Sophos për nevojat e FKPK-së	26.07.2023	€ 28,500.00	€ 23,989.65	€ 4,510.35
38	UA/2016-23-5807-2-2-1	Sigurimi i automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura	27.07.2023	€ 109,165.50	€ 90,952.99	€ 18,212.51
42	UA/2016-23-5402-1-2-1	Pajisje për përkthim për nevojat e Akademisë së Drejtësisë	03.08.2023	€ 6,100.00	€ 5,750.00	€ 350.00
48	UA/2016-23-8325-1-3-6	Furnizim me projektor për nevojat e APK-së	31.08.2023	€ 600.00	€ 427.00	€ 173.00
49	UA/2016-23-8325-1-3-6	Furnizim me Hologram 3D për nevojat e APK-së	31.08.2023	€ 900.00	€ 884.00	€ 16.00
50	UA/2016-23-7914-2-2-1	Shërbime të transportit ajror për Nevojat e Agjencive të Pavarura	31.08.2023	€ 94,400.00	€ 92,984.00	€ 1,416.00

51	UA/2016-23-9413-2-4-7	Shërbimet e reklamimit për nevojat e APK-së	07.09.2023	€ 999.00	€ 949.90	€ 49.10
52	UA/2016-23-7230-1-2-1	Furnizim me materiale të shtypura dhe dizajn-botime dhe publikime për nevojat e Akademisë së Drejtësisë	31.08.2023	€ 30,000.00	€ 22,666.00	€ 7,334.00
53	UA/2016-23-9568-1-4-7	Furnizim me letër me masa mbrojtëse të sigurisë për nevojat e AAC-së	13.09.2023	€ 986.00	€ 952.00	€ 34.00
54	UA/2016-23-8524-2-3-6	Lot II - Zhvillimi i Videove Për Promovimin e Punës së APK-së	08.09.2023	€ 1,000.00	€ 858.00	€ 142.00
55	UA/2016-23-7706-2-1-1	Mirëmbajtja e sistemit për monitorim të mediave për nevojat e KPM-së	22.09.2023	€ 242,100.00	€ 242,064.00	€ 36.00
56	UA/2016-23-6134-2-1-1	Shërbimet e përkthimit dhe lektorimit për nevojat e Agjencive të Pavarura	20.09.2023	€ 167,009.93	€ 167,009.93	€ -
57	UA/2016-23-10204-1-4-7	Furnizim me TV SMART për nevojat e AAC-së	25.09.2023	€ 700.00	€ 635.00	€ 65.00
60	UA/2016-23-10740-1-4-7	Furnizim me rekuizita për nënshkrimin e marrëveshjes ne mes ARKEP dhe agjensioneve si motra nga Shqipëria, Maqedonia e veriut dhe Mali i Zi	06.10.2023	€ 980.00	€ 975.00	€ 5.00
63	UA/2016-23-9618-2-3-6	Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve të AAC-së	12.10.2023	€ 4,796.00	€ 3,033.30	€ 1,762.70
64	UA/2016-23-6214-2-2-1	Pjesa 1-Mirëmbajtja dhe rifreskimi i ueb-faqes së Autoritetit të Aviacionit Civil	11.10.2023	€ 3,000.00	€ 1,620.00	€ 1,380.00
65	UA/2016-23-6214-2-2-1	Pjesa 2-Ri-dizajnimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i web faqës se Agjencisë për Informim dhe Privatësi	11.10.2024	€ 1,800.00	€ 900.00	€ 900.00
66	UA/2016-23-6214-2-2-1	Pjesa 3-Ri-disajnim, mirëmbajtje, zhvillim te web faqes, hostim dhe rezervim te domenit për Autoritetin Kosovar të Konkurrences	11.10.2025	€ 1,800.00	€ 900.00	€ 900.00

67	UA/2016-23-6214-2-2-1	Pjesa 4-Ri- dizajnimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i web-faqes për Agjencine për Parandalimin e Korrupsionit	11.10.2026	€ 6,000.00	€ 2,520.00	€ 3,480.00
68	UA/2016-23-11117-1-4-7	Furnizim më printer për barkode dhe shirita për barkode	16.10.2023	€ 999.90	€ 940.00	€ 59.90
72	UA/2016-23-11303-1-4-7	Furnizim me TV SMART për nevojat e AAC-së	19.10.2023	€ 700.00	€ 700.00	€ -
73	UA/2016-23-9759-1-2-1	Furnizim me licenca për softver për nevojat e FKPK-së	30.10.2023	€ 41,500.00	€ 26,584.11	€ 14,915.89
74	UA/2016-23-9759-1-2-1	Furnizim me Oracle Database 19c Standard Edition 2 Release 19 On-Premises për nevojat e FKPK-së	30.10.2023	€ 25,000.00	€ 24,980.00	€ 20.00
76	UA/2016-23-9785-1-2-1	LOT 1- Furnizim me laptop per nevojat e Zyres se Rregullatorit për Energji	06.11.2023	€ 4,500.00	€ 4,395.00	€ 105.00
77	UA/2016-23-9785-1-2-1	LOT 2- Furnizim me PC dhe Monitor për nevojat e Autoritetit te Konkurrences	06.11.2023	€ 7,840.00	€ 5,887.00	€ 1,953.00
78	UA/2016-23-9785-1-2-1	LOT 3- Furnizim me PC - për nevojat e Komisionit te Pavarur te Mediave	06.11.2023	€ 4,000.00	€ 3,719.00	€ 281.00
79	UA/2016-23-9785-1-2-1	LOT 4- Furnizim me laptop - për nevojat e Agjencionit për Parandalimin e Korrupsionit	06.11.2023	€ 4,000.00	€ 3,992.00	€ 8.00
80	UA/2016-23-11404-2-3-6	Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes se objektit të AIP-it-Ritender	09.11.2023	€ 3,500.00	€ 2,985.70	€ 514.30
83	UA/2016-23-1520-5-4-7	Riparimi i rregullt i sistemit adresibil të lajmërimit të zjarrit për komplet objektin e ARKEP-it	03.03.2023	€ 900.00	€ 890.00	€ 10.00
84	UA/2016-23-5078-2-4-7	Ndërrimi, balancimi dhe hotelimi i gomave të veturave për nevojat e ARKEP-it	22.05.2023	€ 980.00	€ 970.00	€ 10.00
85	UA/2016-23-12748-2-4-7	Fuqizimi i prezencës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit të Kosovës në media sociale	17.22.2023	€ 990.00	€ 990.00	€ -

86	UA/2016-23-13319-5-5-8	Furnizim me pajisje të IT-së për Nevojat e Agjencive të Pavarura	21.12.2023	€ 18,680.00	€ 13,106.00	€ 5,574.00
92	UA/2016-23-12505-1-2-1	Furnizim me ushqim të gatshëm dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime në Akademinë e Drejtësisë	29.12.2023	€ 100,000.00	€ 90,730.00	€ 9,270.00
<b>Gjithsejtë:</b>				<b>€ 1,575,995.13</b>	<b>€ 1,399,464.40</b>	<b>€ 176,530.73</b>

## 2.2 Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrimin e kontratave nga DPV sipas nenit 95.4 të LPP-së për Agjencitë e Pavarura.

2.2.1. Lista e kontratave të nënshkruar nga AQP në emër të Agjencisë të Punësimit të Republikës së Kosovës.

<i>Nr. rendor</i>	<i>Numri i prokurimit</i>	<i>Titulli i Kontratës</i>	<i>Data e nënshkrimit të kontraktues</i>	<i>Vlera e parashikuar ne €</i>	<i>Vlera e kontraktuar ne €</i>	<i>Ndryshimet</i>
1	UA/2016-23-4711-2-2-1	Lot 4 - Angazhimi i një Trajneri për profesionin e Rrobaqepesisë për nevoja të QAP- it në Gjakovë	23.06.2023	€ 6,000.00	€ 6,000.00	€ -
2	UA/2016-23-4711-2-2-1	Lot 5 - Angazhimi i një Trajneri për profesionin Kuzhinier e për nevoja të QAP- it në Gjilan	23.06.2023	€ 6,000.00	€ 6,000.00	€ -
3	UA/2016-23-7332-2-4-7	Shërbimet e pastrimi të objektit të QAP Pejë	19.07.2023	€ 990.00	€ 990.00	€ -
4	UA/2016-23-6698-2-3-6	Mbikëqyrja profesionale e projekteve (kontratave për punë) për APRK	28.07.2023	€ 9,000.00	€ 4,900.00	€ 4,100.00
5	UA/2016-23-6107-1-2-1	Furnizim me paisje për Qendrat për Aftësim Profesional (QAP) për nevojat e APRK - ritender	31.08.2023	€ 80,000.00	€ 78,404.00	€ 1,596.00
6	UA/2016-23-8457-2-2-5	Shërbimet e Sigurimit fizik të objekteve të APRK-së Ri-Tender	16.08.2023	€ 30,000.00	€ 29,400.00	€ 600.00



7	UA/2016-23-7395-1-2-1	Furnizim me material trajnimi per nevojat e QAP në kuadër të APRK-së	24.08.2023	€ 30,517.45	€ 28,443.30	€ 2,074.15
8	UA/2016-23-7117-2-2-1	Lot 3 - Angazhimi i një Trajneri për profesionin e Furrtaar& pastiçeri për nevoja të QAP- it në Prishtinë.	24.08.2023	€ 6,000.00	€ 6,000.00	€ -
9	UA/2016-23-7117-2-2-1	Lot 2 – Angazhimi i një Trajneri për profesionin e Ndërtimtarisë për nevoja të QAP- it në Prizren	24.08.2023	€ 6,000.00	€ 6,000.00	€ -
10	UA/2016-23-7348-5-2-1	Renovimi i zyrës së punësimit në Skenderaj për nevojat e APRK-së	27.09.2023	€ 20,000.00	€ 12,222.22	€ 7,777.78
11	UA/2016-23-4836-5-2-1	Vazhdimi i punimeve për ndërtimin e Zyrës së Punësimit në Gjakovë në kuadër te APRK-së	14.07.2023	€ 200,000.00	€ 149,988.04	€ 50,011.96
12	UA/2016-23-10378-5-2-1	Renovimi i objektit QAP - Pejë	06.11.2023	€ 30,000.00	€ 24,100.59	€ 5,899.41
13	UA/2016-23-9156-2-1-1	Shërbimet e Sigurimit fizik të objekteve të APRK-së - Ritender	14.11.2023	€ 130,000.00	€ 124,862.88	€ 5,137.12
14	UA/2016-23-11547-2-2-1	Lot 1 – Angazhimi i një (1) trajneri për profesionin Parukeri Grim për nevoja të QAP--it Mitrovicë	30.11.2023	€ 6,240.00	€ 6,120.00	€ 120.00
15	UA/2016-23-11547-2-2-1	Lot 2 - Angazhimi i një (1) trajneri për profesionin e Zdrukthëtarisë për nevoja të QAP-it në Ferizaj	31.11.2023	€ 6,240.00	€ 6,240.00	€ -
<b>Gjithsejtë:</b>				<b>€ 566,987.45</b>	<b>€ 489,671.03</b>	<b>€ 77,316.42</b>

2.2.3. Lista e kontratave të nënshkruar nga AQP në emër të Agjencisë së Statistikave të Republikës së Kosovës.

<i>Nr. rendor</i>	<i>Numri i prokurimit</i>	<i>Titulli i Kontratës</i>	<i>Data e nënshkrimit të kontraktues</i>	<i>Vlera e parashikuar ne €</i>	<i>Vlera e kontraktuar ne €</i>	<i>Ndryshimet</i>
1	UA/2016-23-6365-5-5-8	Furnizim me pajisje te TI-se për nevojat e ASK-së	17.07.2023	€ 463,900.00	€ 348,950.00	€ 114,950.00
2	UA/2016-23-6184-1-1-1	Furnizim me uniforma dhe çanta për nevojat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës	01.08.2023	€ 157,500.00	€ 133,650.00	€ 23,850.00
3	UA/2016-23-6181-1-1-1	Furnizim me tablet për nevojat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës	22.08.2023	€ 1,120,000.00	€ 230,580.00	€ 889,420.00
4	UA/2016-23-11027-1-1-5	Furnizim me tablet për nevojat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për regjistrimin e popullsisë 2023 - Lot 1	17.10.2023	€ 480,000.00	€ 248,850.00	€ 231,150.00
5	UA/2016-23-11027-1-1-5	Furnizim me tablet për nevojat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për regjistrimin e popullsisë 2023 - Lot 2	17.10.2023	€ 320,000.00	€ 165,900.00	€ 154,100.00
6	UA/2016-23-11027-1-1-5	Furnizim me tablet për nevojat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për regjistrimin e popullsisë 2023 - Lot 3	17.10.2023	€ 320,000.00	€ 165,900.00	€ 154,100.00
<b>Gjithsejtë:</b>				<b>€ 2,861,400.00</b>	<b>€ 1,293,830.00</b>	<b>€ 1,567,570.00</b>

2.2.4. Lista e kontratave të nënshkruar nga AQP në emër të Thesarit të Republikës së Kosovës.

<i>Nr. rendor</i>	<i>Numri i prokurimit</i>	<i>Titulli i Kontratës</i>	<i>Data e nënshkrimit të kontraktues</i>	<i>Vlera e parashikuar ne €</i>	<i>Vlera e kontraktuar ne €</i>	<i>Ndryshimet</i>
1	UA/2016-23-8817-2-2-1	Mirëmbajtja e licencave të Oracle për nevoja të Thesarit	03.10.2023	€ 120,000.00	€ 120,000.00	€ -
2	UA/2016-23-9392-2-2-1	Vazhdimi i garancisë dhe mbështetjes për pajisje të TI-së së Qendrës së rimëkëmbjes për nevojat e Thesarit	11.10.2023	€ 50,000.00	€ 45,650.00	€ 4,350.00
3	UA/2016-23-7588-2-2-1	Avancimi i platformës së prokurimit elektronik – nderlidhja me sistemin e Thesarit	15.11.2023	€ 75,000.00	€ 71,980.00	€ 3,020.00
4	UA/2016-23-12172-2-1-1	Shërbime dhe produkte bankare për nevojat e Thesarit të Republikës së Kosovës dhe Organizatave Buxhetore-Rittender	11.12.2023	€ 150,000.00	€ 150,000.00	€ -
5	UA/2016-23-13573-2-1-5	Mirëmbajtja e Sistemit të Menaxhimit të Pagave për nevojat e Thesarit të Kosovës-Ri-tender	29.12.2023	€ 215,000.00	€ 205,000.00	€ 10,000.00
6	UA/2016-23-12958-2-2-1	Upgrade i sistemit të Arkivës Dixhitale Docushare për nevoja e Thesarit të Kosovës.	29.12.2023	€ 45,000.00	€ 42,893.00	€ 2,107.00
<b>Gjithsejtë:</b>				<b>€ 655,000.00</b>	<b>€ 635,523.00</b>	<b>€ 19,477.00</b>

## Aneksi 3. TABELA E PJESEMARRSVE NE TRAJNIME

Trajnim për urdhër blerje		
Emri dhe mbiemri	Pozita	Email
1. Fation Alaj	Zv. Shef i sektorit për Prokurime të Veçanta	<a href="mailto:fation.alaj@rks-gov.net">fation.alaj@rks-gov.net</a>
Programi i avancuar i prokurimit <sup>2</sup>		
Emri dhe mbiemri	Pozita	Email
1. Libona Thaçi	Zyrtare e Prokurimit	<a href="mailto:libona.thaqi@rks-gov.net">libona.thaqi@rks-gov.net</a>
2. Blerina Haziraj	Zyrtare e Prokurimit	<a href="mailto:Blerina.haziraj@rks-gov.net">Blerina.haziraj@rks-gov.net</a>
3. Liridona Malaj	Zyrtare e Prokurimit	<a href="mailto:Liridona.malaj@rks-gov.net">Liridona.malaj@rks-gov.net</a>
4. Ardiana Hajdari	Zyrtare e Lartë e Personelit	<a href="mailto:Ardiana.hajdari@rks-gov.net">Ardiana.hajdari@rks-gov.net</a>
5. Qendresa Maliqi	Zyrtare Ligjore	<a href="mailto:Qendresa.maliqi@rks-gov.net">Qendresa.maliqi@rks-gov.net</a>
6. Granit Morina	Asistent	<a href="mailto:Granit.morina@rks-gov.net">Granit.morina@rks-gov.net</a>
Trajnim për Transferim, Pezullim dhe Përfundimin e marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil		
1. Ardiana Hajdari	Zyrtare e Lartë e Personelit	<a href="mailto:Ardiana.hajdari@rks-gov.net">Ardiana.hajdari@rks-gov.net</a>
Trajnim për Planifikimin e Burimeve Njerëzore (Hartimi i planit të Personelit)		
1. Ardiana Hajdari	Zyrtare e Lartë e Personelit	<a href="mailto:Ardiana.hajdari@rks-gov.net">Ardiana.hajdari@rks-gov.net</a>
Sistematizimi i vendeve të punës		
1. Ardiana Hajdari	Zyrtare e Lartë e Personelit	<a href="mailto:Ardiana.hajdari@rks-gov.net">Ardiana.hajdari@rks-gov.net</a>

<sup>2</sup> <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=602>